

GJYKATË E HAPUR

Buletin informativ i
Gjykatës Themelore të Prizrenit
Qershor – Gusht 2016

Buletin informativ “Gjykatë e Hapur”
Nr. 6, Shtator 2016
Botues: Gjykata Themelore e Prizrenit
www.gjyqesori-rks.org

PËRMBAJTJE:

FJALA E ZËDHËNËSES SË GJYKATËS

STORIE E SUKSESIT

Vazhdojnë vizitat e qytetarëve ne Gjykatën
Themelore të Prizrenit

LAJME

GJYKATA NË NUMRA

Dëshmia numerike e përkushtimit

GJYKATA NË MEDIA

Kumtesat për media të Zyrës për Informim

INTERVISTË E SHKURTË

Nehat Idrizi - Kryesues i Këshillit Gjyqësor të
Kosovës

SI TI QASEMI GJYKATËS?

Zyra për Mbështetje Juridike

A e dini se...?!

KONTAKTONI GJYKATËN THEMELORE TË PRIZRENIT



Të nderuar lexues,

Besimi i qytetarëve në gjyqësor varet nga mënyra se si mediat e portretizojnë sistemin ligjor. Gjyqësori ynë do të flasë me një zë të qartë dhe të qëndrueshëm, dhe do të dëgjoj me kujdes zërin e njerëzve. Sistemi gjyqësor mbron sundimin e ligjit duke i shërbyer interesit publik.

Ekzistojnë mendime të ndryshme që e përcaktojnë demokracinë, por vetëm dy janë që e mbrojnë demokracinë si: shtypi i lirë dhe gjyqësori i pavarur.

Qeverisja e mirë nuk nënkupton vetëm shërbimin ndaj qytetarit, por edhe komunikimin e duhur madje më shumë se gjysma e qeverisjes së mirë është komunikimi, ndërsa pjesa tjetër është shërbimi.

Zyra e Informimit, si një segment shumë i rëndësishëm brenda një sistemi demokratik, shërben si urë lidhëse mes gjykatës dhe publikut. Në janarin e vitit 2013 filluan reformat gjyqësore në sistemin e drejtësisë. Me këto reforma ndryshoi edhe struktura e brendshme e gjykatës. Në këtë vit filloi punën edhe Zyra për informim publik e cila u paraqiti si domosdoshmëri në brendinë e gjykatës, në atë mënyrë që opinioni publik të njihet më për së afërmi me punën që bëhet brenda këtij institucioni të drejtësisë. Përmes kësaj zyre, informacioni shpërndahet në mënyrë më të drejtë, më të shpejtë dhe më të saktë, prandaj do të jetë e hapur për të gjithë ata që dëshirojnë të marrin informacion për punën e gjykatës. Kjo zyre është urë lidhëse në mes gjykatës dhe qytetarit, duke lehtësuar komunikimin mes të dyja palëve.

Gjykata Themelore e Prizrenit është duke punuar intensivisht në rritjen e komunikimit me qytetarët. Për këtë qëllim gjykata në bashkëpunim me organizatën joqeveritare "EC Ma Ndryshe" ka hapur një dritare të re të transparencës, ku kemi promovuar produkte të reja të komunikimit të cilat kanë për qëllim rritjen e transparencës dhe forcimin e komunikimit me qytetarët, siç janë: Strategjia e Komunikimit, broshura "Si ti qasemi gjykatës", të cilat përmbajnë informacione relevante për punën e gjykatës dhe të drejtat e qytetarëve, si dhe spotin televiziv që ka përmbajtje informative për punën e gjykatës dhe është transmetuar në të gjitha televizionet lokale dhe e njëjta po transmetohet në televizionin publik.

Produkti i katërt është Buletini informativ në baza tremujore "Gjykatë e Hapur" e cila është edhe një dritare e re e transparencës dhe punës së Gjykatës Themelore Prizrenit që synon fuqizimin e besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë në përgjithësi, dhe në punën e gjykatës në veçanti. Pra me sukses po publikohet numri i 6-të i këtij buletini.

Gjykata e Prizrenit ka bashkëpunim të mirë me të gjitha mediat, me shkollat dhe Universitetin e Prizrenit. Gjykata së bashku me Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren dhe OJQ "EC Ma Ndryshe" ka krijuar një program të praktikantëve, i cili mbështet Zyrën për informim publik të gjykatës dhe që është zyrtarizuar me nënshkrimin e marrëveshjes së mirëkuptimit. Me angazhimin e praktikantëve kemi realizuar një numër të madh veprimesh në emër të rritjes së komunikimit të gjykatës me qytetarët.

Në emër të Gjykatës Themelore të Prizrenit i falënderoj të gjithë bashkëpunëtorët nga shoqëria civile, mediat, Universitetin, kolegjet, shkollat dhe segmentet tjera të shoqërisë të cilët japin kontributin e tyre, për një gjykatë të hapur dhe transparente.

Afërdita Kicaj

Zyrtare për Informim Publik-Zëdhënëse

Vazhdojnë vizitat e qytetarëve në Gjykatën Themelore të Prizrenit

Praktikantja në Zyrën për Informim Publik të Gjykatës Themelore në Prizren, ka filluar punën e saj praktike duke organizuar vizitën me qytetarë. Më datën 15 korrik 2016, Gjykatën Themelore të Prizrenit e vizituan disa qytetarë. Kjo Gjykatë i ka hapur dyert e saj për të gjithë qytetarët e interesuar që dëshirojnë ta vizitojnë dhe të mësojnë më shumë për punën e saj. Komunikimi i qytetarëve me shërbyesit e drejtësisë është një parakusht për krijimin e besimit në drejtësinë që ndahet në këtë gjykatë dhe e mban të informuar gjykatën për kërkesat që kanë qytetarët. Vizita kishte për qëllim të nxisë komunikimin më të besueshëm mes qytetarëve dhe Gjykatës Themelore në Prizren dhe tu mundësoj atyre të njihen për së afërmi me gjykatën e tyre. Qytetarët u vendosën në njërën nga sallat e gjyqimit ku u pritën nga gjyqtari i Krimeve të Rënda njëherësh anëtari i Këshilli Gjyqësor të Kosovës z. Skënder Çoçaj, si dhe zëdhënësja e kësaj gjykate Afërdita Kicaj. Prezantimet u pasuan me diskutim mes qytetarëve dhe përfaqësuesve të gjykatës. Ndër të tjera u diskutua për kërkesat, nevojat dhe shqetësimet që kanë të dyja palët në raport me gjykatën dhe drejtësinë.



LAJME

Kryetari i Gjykatës së Lezhës, Ded Dedaj së bashku me stafin mbështetës vizitoi Gjykatën Themelore të Prizrenit



Prizren, 12 maj 2016 – Kryetari i Gjykatës Themelore të Prizrenit z.Ymer Hoxha, ka pritur në takim Kryetarin e Gjykatës së Lezhës (R.Shqipërisë) së bashku me stafin mbështetës.

Kryetari Hoxha në këtë takim i ka njoftuar me funksionimin e Gjykatës Themelore të Prizrenit, historikun e kësaj gjykate, procesin e zgjedhjes së gjyqtarëve të rinj, mandatin e tyre, pastaj ndryshimet që kanë ndodhur në sistemin gjyqësor si pasojë e reformave, dhe sfidat me të cilat gjyqësori kosovar po përballlet aktualisht.

“Pas reformave të sistemit gjyqësor, ndryshimet kanë qenë në tri dimensione, në aspektin e infrastrukturës ligjore, të strukturës organizative të gjyqësorit dhe në aspektin e bartësve të funksioneve gjyqësore”, ka thënë kryetari Hoxha. Ndërkaq, ka shtuar se, “sa i përket efikasitetit, mund të themi se jemi gjykatë efikase, pasi jemi duke punuar në lëndë të vitit 2016”. Në anën tjetër, kryetari i Gjykatës së Lezhës ka pohuar se procesit të reformave i është nënshtruar edhe sistemi gjyqësor në Shqipëri.

Tryezë e rrumbullakët: Prezantimi i raportit të OSBE-së mbi zbatimin e Kodit të ri të Procedurës Penale

Më 14 qershor, në Prizren, misioni i OSBE-së në Kosovë mbajti një tryezë të rrumbullakët me gjyqtarë, avokatë, mbrojtës të viktimave dhe bashkëpunëtorë profesionalë në të cilën u bë prezantimi i raportit "Shqyrtimi i zbatimit të Kodit të ri të Procedurës Penale".

Ky raport i publikuar nga OSBE-ja, ofron një pasqyrë të përgjithshme të zbatimit të Kodit të ri, që ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2013, duke sjellë kështu ndryshime të mëdha në procedurën penale dhe duke u dhënë role të zgjeruara mbrojtjes dhe prokurorisë, ndërsa gjyqtarëve përgjegjësi dhe kompetenca të reja që u mundësojnë atyre të veprojnë më mirë si mbrojtës të të drejtave të palëve.



Në këtë tryezë morën pjesë rreth njëzet pjesëmarrës. Tryeza është hapura nga kryetari Ymer Hoxha, në emër të Gjykatës Themelore të Prizrenit dhe zyrtari ligjor Meriton Pajaziti nga misioni i OSBE-së në Kosovë, i cili edhe e moderoi takimin. Më pas u vazhdua me një diskutim përmbajtjesor në lidhje me të gjeturat e raportit, të cilat u pranuan në mënyrë konstruktive nga të gjithë pjesëmarrësit. Raporti jep rekomandime për përmirësimin e zbatimit të këtij Kodi nga institucionet përkatëse, me qëllim të garantimit më të mirë të së drejtës për një gjykim të drejtë.

Kopje elektronike e Raportit: <http://www.osce.org/sq/kosovo/243981?download=true>

Vizitë në degën e Gjykatës Themelore në Suharekë

Më 18 qershor 2016, zëdhënësja e Gjykatës Themelore të Prizrenit Afërdita Kicaj pati një takim pune me administratorin e degës së Gjykatës Themelore në Suharekë. Pjesë e këtij takimi ishin edhe praktikantja e Zyrës për Informim Publik si dhe një përfaqësuesi i OJQ-së "EC Ma Ndryshe".

Qëllimi kryesor i kësaj vizite ishte njohja më për së afërmi me mbarëvajtjen e punës së kësaj gjykate dhe mundësinë e qasjes më të lehtë të qytetarëve në gjykatë.



Gjatë këtij takimi u diskutuan edhe çështje tjera të rëndësishme. Ndër të tjera u pa edhe këndi për informim publik. Ky kënd u pajis me Buletinin Informativ të Gjykatës Themelore të Prizrenit i cili publikohet çdo tre muaj, dhe me mjete tjera të transparencës si: Strategjia e Komunikimit, "Si t'i qasemi gjykatës". U diskutua edhe për spotin televiziv i cili shfaqet në RTK3, faqen në facebook "Gjykatë e Hapur" dhe ueb portalin e gjykatës www.gjyqesori-rks.org

GJYKATA NË NUMRA

Dëshmia numerike e përkushtimit

Tabela e mëposhtme paraqet statistikat e lëndëve të Gjykatës Themelore në Prizren për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016, si ato të trashëguara në fillim të vitit 2016, të ardhura, lëndët ne proces, lëndët që janë përfunduar në këtë gjashtë mujor dhe ato të mbetura në fund të gjashtë mujorit të parë të vitit 2016. Statistikat e punës për gjashtë mujorin e parë të vitit 2016 janë dëshmia e radhës numerike e përkushtimit maksimal të gjykatës për t'i shërbyer qytetarëve.

Gjykata Themelore në Prizren*	Lëmia	Lëndët e trashëguara në fillim të 2016	Lëndët e ardhura gjatë VI-të mujorit të I-rë 2016	Gjithsej lëndët në punë gjatë VI-të mujorit të I-rë 2016	Lëndët e kryera gjatë VI-të mujorit të I-rë 2016	Lëndët e mbetura në fund të VI-të mujorit të I-rë 2016
Dep. për Krime të Rënda	Penale	253	115	368	114	254
	Paraprake	233	129	362	118	244
Dep. i Përgjithshëm	Penale	3208	1423	4631	1065	3566
	Paraprake	384	167	551	50	501
	Civile	1511	643	2154	833	1321
	E.Civile	11178	1778	12956	2453	10503
	E.P. Me Burg	162	58	220	94	126
	E.P. Me Gjobë	821	761	1582	486	1096
	Të Ndryshme	0	5824	5824	5824	0
	Trashëgimore	31	38	69	54	15
	Jashtkontestimore	282	297	579	321	258
Dep. për të Mitur	Penale Para Kolegjit	232	54	286	68	218
	Përgatitore	71	69	140	56	84
Divizioni i Kundërvajtjes	Kundërvajtje	10447	19541	29988	19090	10898
TOTALI		28813	30897	59710	30626	29084

GJYKATA NË MEDIA

Kumtesat për media të Zyrës për Informim

Gjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2016, Zyra për Informim e Gjykatës Themelore të Prizrenit ka lëshuar rreth 40 kumtesa për media, të cilat kanë pas për qëllim të njoftojnë publikun mbi rastet e paraburgimeve dhe të shqiptimit të dënimeve për seancat që janë të hapura për publikun. Kumtesat për media të gjykatës janë paraqitur në të gjitha televizionet lokale në pothuaj të gjitha rastet. Me qëllim njoftimit të publikut për seancat gjyqësore që mbahen në gjykatë, Zyra për Informim ka vazhduar të njoftojë mediat në baza të përditshme me tabelën e seancave gjyqësore, të cilat kanë njoftuar rreth orës, sallës së gjyqimit, numrit të lëndës dhe gjyqtarit të lëndës.



NEHAT IDRIZI
Kryesues i Këshillit
Gjyqësor të Kosovës

Këshilli Gjyqësor i Kosovës është institucion i Republikës së Kosovës, mandati i të cilit buron nga Kushtetuta dhe Ligji për KGJK, përgjegjës për administrimin e përgjithshëm të sistemit gjyqësor të Kosovës, si dhe sigurimin e pavarësisë dhe paanësisë së gjykatave.

1. Cila është sfida më e madhe e gjyqësorit sot në Kosovë?

Sfida kryesore që e përcjellë sistemin gjyqësor të Kosovës ndër vite është numri i madh i rasteve të grumbulluara që drejtpërdrejtë ndikon në efikasitetin e gjykatave. Sfidë tjetër që ndërlidhet me të parën është edhe numri jo i mjaftueshëm i gjyqtarëve për të shqyrtuar lëndët që pranohen në gjykatë. Në këtë drejtim, KGJK ka shpallur konkurs për rekrutimin e 61 kandidatëve për gjyqtar në Gjykatat Themelore, 2 gjyqtarë në Gjykatën Supreme, 4 gjyqtarë në Gjykatën e Apelit. Ky numër i gjyqtarëve, pritet të ketë ndikim pozitiv në ngritjen e efikasitetit të gjykatave.

2. Sa transparente është puna e gjykatave në Kosovë? A mendoni se qytetarët dinë mjaft për gjyqësorin?

Në bazë të ligjeve procedurale, gjithsecili ka të drejtë të merr pjesë në seancat gjyqësore që zhvillohen në gjykata. Madje në disa gjykata, orari i seancave bëhet publik dhe qytetarët kanë mundësi t'i ndjekin ato. Meqë publiciteti i gjykimeve është i garantuar (seancat janë publike), mendoj se mund të konkludohet se gjykatat janë transparente në punën e tyre. Ndoshta ne si KGJK, në bashkërendim edhe me gjykatat, mund të bëjmë diçka më shumë në informimin e qytetarëve për punën e gjyqësorit. KGJK ka lansuar ueb portalin e gjykatave, tani bëhen publike edhe aktgjykimet e plotfuqishme.

Është shembull pozitiv Gjykata Themelore e Prizrenit e cila është duke punuar intensivisht në rritjen e transparencës duke bashkëpunuar me OJQ EC Ma Ndryshe, e promovojnë buletin informativ në baza tre mujore me emrin "Gjykatë e Hapur" e që e vlerësoj si një hap pozitiv, ku duhet të merret shembull edhe për gjykatat tjera.

3. A gëzojnë gjykatësit dhe stafi tjetër i gjykatave siguri të mjaftueshme në kryerjen e punëve të tyre?

Çështjen e sigurisë së gjyqtarëve e përcjellim me vëmendje të veçantë. Siguria e tyre është parakusht për të pasur pavarësi dhe paanësi. Është vështirë të thuhet se a kanë apo s'kanë siguri të mjaftueshme, megjithatë ajo çfarë është e rëndësishme është se ekzistojnë mekanizma për tu ofruar siguri gjyqtarëve në rast të kërcënimit ndaj tyre.

4. Shpesh raportohet për ndërhyrje në pavarësinë e gjyqësorit? A ka të vërtetë në këtë?

Misioni i KGJK-së është sigurimi i pavarësisë dhe paanësisë së sistemit gjyqësor. Kjo garantohet edhe me Kushtetutë. Konsideroj se edhe përbërja aktuale e KGJK-së (shumica e anëtarëve zgjedhen nga gjyqësori) është garanci shtesë ndaj ndërhyrjeve të jashtme. Megjithatë, nuk mund ta përjashtoj si mundësi që të ketë pasur ndërhyrje në pavarësinë e gjyqësorit.

5. Sa janë të konsoliduara Zyrat për Informim të Gjykatave? A kanë të gjitha gjykatat zyrtar për Informim dhe a përkrahen mjaftueshëm në rritjen e kapaciteteve?

Të gjitha gjykatat kanë zyrtar për informim me publikun duke e veçuar Gjykatën Themelore të Mitrovicës dhe Gjykatën Themelore të Gjakovës, ku së shpejti edhe në këto gjykata pritet të funksionojë Zyra për Informim publik. Këta zyrtarë, në koordinim edhe me Zyrën për Komunikim brenda KGJK-së kanë rolin kryesor në ndërtimin e marrëdhënieve gjyqësor-media-publik.

Zyra për Mbështetje Juridike

Zyra për Mbështetje Juridike (ZMJ) përfshinë të gjithë personelin teknik i cili u ndihmon gjykatësve në mbajtjen dhe transkriptimin e seancave si dhe në përpilimin e aktgjykimeve, siç janë: sekretarët juridikë, përkthyesit dhe bashkëpunëtorët profesionalë. ZMJ-ja do të ndihmojë dhe bashkërendoj punët tekniko-administrative të ndërlidhura me interpretimin, transkriptet, procesverbalin, hulumtimin ligjor dhe përpilimin e aktgjykimeve.

A e dini se...?!

- Gjykatat Themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe.
- Gjykatat Themelore janë kompetente për të dhënë ndihmë juridike ndërkombëtare dhe për të vendosur për pranimin e vendimeve të gjykatave të huaja.
- Çështjet administrative dhe ekonomike janë kompetencë ekskluzive të Gjykatës Themelore të Prishtinës. (LIGJI Nr. 03/L-199 PËR GJYKATAT, Neni 11)



KONTAKTONI GJYKATËN THEMELORE TË PRIZRENIT

ZYRA E ADMINISTRATËS:

Tel: +381 (0) 29 / 244 122

ADRESA:

Gjykata Themelore e Prizrenit
Rr. "Ibrahim Lutfiu ", p.n.
Prizren, Kosovë

VIZITO:

www.gjyqesori-rks.org



GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

OSNOVNI SUD U PRIZRENU –PRIZREN TEMEL MAHKEMESI
BASIC COURT OF PRIZREN



Organizata Jo-Qeveritare Emancipimi Civil Ma Ndryshe
EC MA NDRYSHË

*Ky publikim është rezultat i bashkëpunimit mes
Gjykatës Themelore të Prizrenit dhe EC Ma Ndryshe,
në kuadër të iniciativës "Gjykatë e Hapur".*